



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/114
Datë: 16.12.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13 (3) të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Vazhdohet afati i autorizimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kompetencën e deleguar Ministrisë së Shëndetësisë përmes Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/11 të datës 07.05.2021, lidhur me procesin e pagesës së furnizimit me vaksinat për COVID - 19, nga prodhuesit - operatorët ekonomik me të cilët është arritur marrëveshja nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikën e Kosovës.
2. Afati i autorizimit i përcaktuar në pikën 5. të Vendimit Nr. 03/11 të datës 07.05.2021 vazhdohet dhe është i vlefshëm deri në dhjetor të vitit 2023, ndërsa paradhëniet do të bëhen në pajtim me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikën e Kosovës.
3. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/11, të datës 07.05.2021, mbesin në fuqi dhe aplikohen në përputhshmëri dhe analogji me të njëjtat kushte për vitin fiskal 2022 dhe vitin fiskal 2023, varësisht nga dinamika e furnizimit me vakcina.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë